



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1138 Prot.

Ballsh, më 28.02.2022

VENDIM

NR. 17 DATË 28 / 02 / 2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 53, DATË 18.07.2018 “PËR MIRATIMIN E VLERËS SË SHPRONËSIMIT TË QYTETARËVE ISUF HODAJ, VELEDIN MEÇANAJ DHE LUAN NUHAJ NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTIT RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES 28 NËNTORI QYTETI BALLSH”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” i ndryshuar, VKM-së nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të VKM-së nr. 89, datë 02.06.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, të projektit “Rikualifikimi Urban i lagjes 28 Nëntori të qytetit Ballsh, Mallakastër”, si dhe referuar shkresës nr. 44 prot., datë 11.01.2022, të Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 164 prot., datë 12.01.2022, të shkresës nr. 25/1 prot., datë 14.02.2022, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Mallakastër administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 340/1 prot., datë 15.02.2022, të procesverbalit të vlerësimit të hartuara nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Në gërmën b, pika 1 e Vendimit nr. 53, datë 18.07.2018 “Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Isuf Hodaj, Veleidin Meçanaj dhe Luan Nuhaj në kuadër të zbatimit të projektit Rikualifikimi Urban i lagjes “28 Nëntori”, qyteti Ballsh”, bëhet ky ndryshim:

Miratimin e vlerës paraprake të shpronësimit si më poshtë (referuar procesverbalit të vlerësimit):

- a. Z. Luan Muhamet Nuhaj- Vlera Totale e shpronësimit = 646,848.75 (gjashtëqind e dyzete e gjashtë mijë e teteqind e dyzete e tete e shtatëdhjetë e pese) lekë.

Vlerësimi paraparak për sipërfaqen e objektit të banimit është kryer në bazë të shkresës nr. 25/1 prot., datë 14.02.2022, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Zyra Vendore Mallakastër, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 340/1 prot., datë 15.02.2022. Vlerësimi paraparak për sipërfaqen e truallit është bërë referuar VKM-së nr. 89, datë 02.06.2016.

KRYETAR

Mbarime Isufaj